

MËSIMDHËNIA E FJALORIT TË GJUHËS SË RE GREKE SI GJUHË E HUAJ

Dr. Isida Metaj (Foçi)

Departamenti i Gjuhës Greke
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: isida.metaj@unitir.edu.al

Ma. Edlira Jorgaqi

Departamenti i Gjuhës Greke
Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës
E-mail: edlira.jorgaqi@unitir.edu.al

PËRMBLEDHJE

Në këtë kumtesë do të analizojmë mësimdhënien e fjalorit të gjuhës së dytë tek studentët e ciklit të parë. Fillimisht paraqiten qasjet kryesore teorike, të cilat kanë të bëjnë me zhvillimin e fjalorit. Në vazhdim referohen dy procedurat bazë në lidhje me mësimdhënien e fjalorit dhe propozohen teknika praktike, të cilat njehsohen dhe aplikohen me qëllim mësimdhënien e fjalorit të gjuhës së dytë. Në përfundim, në këtë punim përshkruhet kuadri i mësimdhënies së fjalorit të gjuhës së dytë gjatë leximit të historive në klasë dhe propozohen praktika leximi, të cilat kontribuojnë në mënyrë efikase në shpjegimin e fjalëve të panjohura dhe si rrjedhojë zhvillimin e fjalorit të gjuhës së dytë. Fjalë **çelës**: fjalor, mësimdhënie e drejtpërdrejtë, mësimdhënie jo e drejtpërdrejtë, strategji për-vetësimi.

ABSTRACT

In this paper we will analyze the teaching of second language vocabulary to undergraduate students. First, the main theoretical approaches to vocabulary development are presented. The following are two basic procedures related to vocabulary teaching and practical techniques are proposed, which are calculated and applied in order to teach a second language vocabulary. In conclusion, this paper describes the teaching framework of a second language vocabulary while reading stories in the classroom and proposes reading practices that contribute effectively to the explanation of unfamiliar words and consequently the development of a second language vocabulary.

Keywords: direct teaching, indirect teaching, learning strategies, vocabulary.

Si nxënës të gjuhëve të huaja të gjithë mund të kemi vënë re se shumë fjalë që na kanë mësuar mund të mos i kujtojmë, por të kujtojmë shumë më tepër fjalë nga ato që u kemi mësuar të tjerëve. Nga ky konstatim rezulton se nga njëra anë mësimdhënia e drejtpërdrejtë e fjalorit nuk është gjithmonë rezultative dhe nga ana tjetër rezulton se nuk është e vetmja mënyrë për të mësuar fjalorin. Por cilat janë mënyrat me të cilat mësojmë fjalët? Në cilat raste i përdorim? Si mund të bëhen më rezultative?

Në përgjithësi ka dy mënyra të qasjes së fjalorit: **e drejtpërdrejtë** dhe **jo e drejtpërdrejtë**. E para ka të bëjë me mësimdhënien e qëllimshme (Nation 2001:120,232-3), Schmitt 2000: 116, 146-149) gjatë të cilës vëmendja jonë përqendrohet tek gjuha dhe synojmë të mësuarit e fjalëve, ndërsa e dyta ka të bëjë me të mësuarin jo të qëllimshëm (Nation 2001:120, 232-3, Schmitt 2000:116), d.m.th. të mësuarit e fjalëve gjatë të kuptuarit të gjuhës së shkruar e të folur, teksa interesi dhe vëmendja jonë fokusohen tek mesazhi që përcillet dhe jo tek gjuha. Kjo është mënyra me të cilën përvetësojmë jo vetëm fjalorin, por edhe gjuhën si folës natyral të saj.

Sipas Nation (2001:232), një program i mirëorganizuar për mësimdhënien e gjuhës së huaj do të duhet të kombinojë si mësimdhënien e qëllimshme të fjalorit, ashtu edhe veprimtaritë që do të sigurojnë të mësuarit e paqëllimshëm të tij, pasi secila nga dy mënyrat mund të mbulojë nevoja të ndryshme. Për fillestarët është e domosdoshme të përdoret mësimdhënia e qëllimshme e fjalorit deri sa të kenë përvetësuar një fjalor bazë që do t'i lejojë të kuptojnë fjalët e panjohura që do të hasin në tekste. Gjithashtu, mësimdhënia e qëllimshme na ndihmon dhe kur duam të japim një fjalor specifik me një tematikë të caktuar. Pra, mësimdhënia e qëllimshme rekomandohet për të mësuarit e një fjalori të caktuar me numër të përcaktuar fjalësh në një periudhë të shkurtër kohore.

Por nga ana tjetër, mësimdhënia jo e qëllimshme është njësoj e domosdoshme në një program mësimi të një gjuhe të huaj, sepse përmirëson cilësinë e leksikut, por kërkon një periudhë më të gjatë kohore dhe kontakt më të madh me tekste të ligjëratës së shkruar e të folur, si dhe zhvillimin e strategjive për të cilat do të flasim në vijim. Ndaj, të dyja qasjet janë të domosdoshme për mësimin e fjalorit dhe nuk përjashtojnë, por plotësojnë përdorimin e njëra tjetrës.

Le të vazhdojmë të shpjegojmë në mënyrë më të hollësishme të dyja këto qasje.

Një nga pyetjet e shumta që duhet t'i përgjigjemi kur për mësimin e një gjuhe të huaj zgjedhim mësimdhënien e qëllimshme të fjalorit është "Si do ta shpjegojmë kuptimin e fjalëve?". Teknikat e përdorura i ndajmë në dy kategori (Nation 1990:51 me ndryshime):

1. Teknika me anë të të cilave tregojmë ç'është fjalë me përdorimin e elementeve jashtë gjuhësorë si: objekte, figura, fotografi, skica, diagrame, gjepte dhe mimikë.
2. Teknika me anë të të cilave shpjegojmë me fjalë në gjuhën amtare të nxënësve apo në një gjuhë tjetër që njohim se çfarë do të thotë fjalë ose shpjegojmë me

fjalë në gjuhën që synojmë të mësojmë duke dhënë një përkufizim analitik, duke përdorur fjalë sinonime, duke e përdorur fjalën brenda një fjalie për të zbuluar kështu kuptimin e saj.

Por këto teknika kanë avantazhet dhe disavantazhet e tyre. Avantazh është se objektet reale, figurat, diagramat, gjestet konsiderohen si mënyra më e vlefshme për të shpjeguar kuptimin e një fjale. Nxënësit shohin zbatimin e kuptimit dhe kjo përforcon mundësitë për ta mbajtur mend. Por ka dhe disa disavantazhe pasi jo të gjitha fjalët mund të shpjegohen me objekte. P.sh nuk mund të shpjegojmë lehtësisht nocionet abstrakte si: ideologji, nocion, përshtypje, informoj, fatmirësisht etj. Gjithashtu duke qenë se ky shpjegim bëhet me një mënyrë jo të drejtpërdrejtë, mundësia e keqkuptimit të nocionit përbën rrezik.

Ndaj, kjo teknikë është e përshtatshme për disa kuptime konkrete fjalësh dhe mund të bëhet më rezultative nëse kombinohet me ndonjë përkufizim të fjalës, që të arrijmë atë që quhet kodim i dyfishtë, d.m.th. magazinim në kujtesë optik dhe gjuhësor njëkohësisht.

Teknika tjetër ka të bëjë me shpjegimin e fjalës në gjuhën amtare të nxënësve ose në gjuhën e synuar. Përkthimi në gjuhën amtare ndoshta është metoda më e shpejtë, më e thjeshtë dhe më e lehtë për të kuptuar nxënësit fjalën, por dhe kjo ka disavantazhet e veta: supozon se të gjithë nxënësit kanë të njëjtën gjuhë amtare dhe që mësuesi duhet ta njohë atë, gjë që nuk ndodh gjithmonë, është mënyrë jo e drejtpërdrejtë dhe i largon nxënësit nga gjuha e synuar, nxit përdorimin e gjuhës amtare dhe ul kohën në dispozicion për gjuhën e synuar, përforcon idenë se ka lidhje respektive tek fjalët e gjuhës amtare dhe asaj të synuar dhe mund të shpjerë në transmetim negativ të elementëve gjuhësorë. Ndërsa shpjegimi në gjuhën e synuar disavantazhet e sipërpërmendura i ka avantazhe. Është mënyrë e drejtpërdrejtë, na lejon të vlerësojmë gjuhën e synuar, por presupozon që nxënësit ë kenë një fjalor elementar për të kuptuar përkufizimin dhe mësuesi duhet të ketë aftësinë të japë një përkufizim të mirë. Ka disa mënyra për të shpjeguar kuptimin e një fjale në gjuhën e synuar. Sipas Richards & Taylor (1992), siç edhe referohen në Nation (2001:90) më kryesoret janë:

Sinonim:	«όμορφος» do të thotë «ωραίος»
Antonim (e kundërta):	«νέος» do të thotë «όχι γέρος»
Përkufizim taksativ:	«vjeshta» është një stinë
Përkufizim me shembuj:	«moblie» quhen kolltuku, karrigia etj
Përkufizim funksional:	«lapsin» e përdorim për të shkruar
Përkufizim gramatikor:	«më i keq» shkalla krahasore e I keq
Përkufizim kategorik:	«familje» një grup njerëzish

Për të ndihmuar nxënësit që të kuptojnë fjalët duhet të kenë parasysh (Nation 2001:90-2):

- Duhet të japim shpjegime sa më të qarta, sa më të shkurtra dhe sa më të thjeshta. Përkufizimet e gjata dhe të ndërlikuara do t'i ngatërrojnë më shumë. Është e rëndësishme të vëmë bazat e duhura për njohjen e leksikut duke e filluar procesin, që për hir të së vërtetës është gradual, me një mënyrë të qartë.
- Është shumë e rëndësishme që në rastin e fjalëve polisemike, të fokusojmë vëmendjen e nxënësve tek kuptimi ekzistues, nga i cili mund të nxjerrin dhe kuptimet e tjera.
- Të tërheqim vëmendjen e nxënësve tek fjalët që I kanë hasur dhe më parë.
- Të ndihmojmë nxënësit të zhvillojnë aftësinë për të njohur dhe kuptuar përkufizimet e fjalëve brenda në tekst.
- Duke pasur parasysh se të kuptuarit e një fjale jo domosdoshmërisht nënkupton dhe të mësuarin e saj, duhet t'i ndihmojmë nxënësit për ta memorizuar atë. Mënyra me të cilën shpjegojmë një fjalë mund të ndikojë jo vetëm për ta kuptuar, por edhe për ta mbajtur mend atë.
- Të shmangim ngatërrimin me fjalë të tjera të ngjashme. Mësimdhënia e disa fjalëve, kryesisht sinonime dhe antonime, por edhe të fjalëve që i përkasin të njëjtës fushë leksikore si p.sh., pjesët e trupit, frutat etj., mund të ngatërrohen, kryesisht në nivel fillestarësh. Ndaj propozohet të mësohet fillimisht kuptimi i një fjale dhe në një fazë të mëvonshme antonimi apo sinonimi i saj.

Si do t'i trajtojmë fjalët?

- Fjalët e panjohura i shmangim ose i zëvendësojmë me fjalë të njohura para se tekstin t'ua japim nxënësve ose nuk i shpjegojmë e nuk u dedikojmë kohë. Fjalë që nuk kanë shumë përdorim dhe që nuk janë të nevojshme për nxënësit dhe nuk janë të rëndësishme për kuptimin e tekstit, mund të hiqen apo të zëvendësohen.
- Shpjegojmë shpejt kuptimin ose japim shpjegime për fjalët e panjohura në fund të tekstit. Me anë të shpjegimeve nxënësit mund ta vazhdojnë leximin pa e ndërprerë dhe pa humbur shumë kohë.
- Fjalët e panjohura mund t'i fusim në një fjalorth. Zakonisht kjo ndodh me fjalë që kanë përdorim të shpeshtë, por nuk duam t'u kushtojmë shumë kohë.
- Mund t'ua mësojmë fjalët që më parë. Kjo mund të ndodhë për pak fjalë, në rast të kundërt mund të mos arrihet rezultati i synuar.
- I ndihmojmë nxënësit të gjejnë kuptimin e fjalëve duke u nisur nga konteksti apo me ndihmën e një fjalori.

- I kushtojmë kohë të mësuarit të kuptimit të fjalëve, duke i përforcuar me ushtrime lidhur me to.

Mësimdhënia jo e drejtpërdrejtë, në antitezë me mësimdhënien e drejtpërdrejtë ka të bëjë me përvetësimin e leksikut nëpërmjet teksteve të ligjëratës së folur dhe të shkruar. Ndërkaq qëllimi dhe interesi jonë nuk është thjesht të mësojmë fjalë, por të komunikojmë. Kjo mënyrë e të mësuarit realizohet nën disa kushte të caktuara dhe ndikohet nga disa faktorë që rrisin apo ulin mundësitë që nxënësit të kenë një logjikë të drejtë leksikore dhe si përfundim të mësojnë fjalën (Jenkins & Dixon (1983), Schmitt (2000:153 dhe Nation (2001:243-4)).

Raporti fjalë të njohura / fjalë të panjohura

Është përlogaritur (Liu & Nation 1985) se që të kenë mundësi nxënësit për të vlerësuar treguesit e tekstit, domethënë të dhënat rrethanore dhe gjuhësore, në të cilat bazojmë përfundimet leksikore, (p.sh, një apo më shumë fjalë në të njëjtën fjali me fjalën e synuar apo në ndonjë fjali tjetër në tekst, elemente fonologjikë, morfologjikë të fjalës, të cilët nxënësi mund t'i lidhë me njohurinë përkatëse që ka në gjuhën e synuar, atë amtare apo në ndonjë gjuhë tjetër), duhet që 95 % e fjalëve që janë në tekst, të jenë të njohura, domethënë nxënësit të hasin 1 fjalë të panjohur në çdo 20 fjalë të njohura.

Se sa ndihmues është një tekst, varet nga prezenca e disa treguesve, numri i tyre, afërsia me fjalën e synuar dhe se sa të qarta janë. Tekstet udhëzuese përmbajnë mjaft tregues të qartë dhe sigurisht që mund të vlerësohen. Është parë se nxënësit mund të përdorin më lehtë tregues që ndodhen më afër fjalës së synuar se sa tregues të përgjithshëm dhe më të largët (Haastrup 1991, Huckin & Bloch 1993, Fraser 1999).

Njohja që ka për botën mund të luajë rol të rëndësishëm në përfundimet leksike. Nxënësit që tashmë kanë një skenar apo skemë të lidhur me temën, mund ta përdorin për të kuptuar tekstin në përgjithësi dhe në veçanti fjalët e panjohura në të.

Njohja e mëparshme e kuptimit të fjalës së synuar, ndihmon në të kuptuarit e tekstit të dhënë. Por nëse nxënësi njeh një kuptim tjetër të fjalës, me shumë mundësi do të mbetet aty dhe nuk do të përpiqet të marrë vesh kuptimin e saj në këtë tekst. Por jo të gjithë nxënësit kanë aftësinë për të vlerësuar treguesit dhe të përdorin strategjinë e rezultateve leksikore. Sigurisht, ata që e kanë, mund të zbërthejnë një numër të madh fjalësh, na lejon të supozojmë se dhe nxënës të tjerë me arsimin e duhur, nëse përftojnë apo përmirësojnë këtë strategji, do të mund të kenë rezultatet e duhura. Sa më të rëndësishme ta konsiderojë fjalën nxënësi, aq më shumë do të përpiqet për ta kuptuar. Sa më shpesh shfaqet një fjalë, aq më shumë mundësi ka nxënësi për ta kuptuar dhe për ta mësuar.

Këtu duhet bërë një dallim midis të kuptuarit të kuptimit dhe përvetësimit. Të kuptuarit e kuptimit të një fjale nuk siguron përvetësimin e saj, pavarësisht se është kusht

për të. Në bazë të studimeve, është konstatuar një paradoks se sa më lehtë të arrijmë të gjejmë kuptimin e një fjale, aq më pak mundësi ka që ta ruajmë në kujtesë (Mondria & Wit-de-Boer 1991). Kjo shpjegohet me bazë teorinë e përpunimit të thellë, sipas së cilës të mësuarit varet mjaftueshëm nga përpjekja mendore dhe thellësia e përpunimit të informacionit. Pra, nëse është shumë e lehtë për ta kuptuar një fjalë, atëherë do të konkludojmë në kuptimin e saj shpejt dhe me shumë mundësi me shumë pak përpjekje. Ky përpunim sipërfaqësor mund të mos sigurojë ngulitjen e saj në mendje. Veç kësaj, nëse teksti është shumë i pasur me tregues, atëherë mund ta kuptojmë duke e anashkaluar fjalën e panjohur. Por, sidoqoftë për të mësuar një fjalë nuk mjafton ta hasim dhe ta kuptojmë vetëm një herë. Siç edhe është përllogaritur, duhet të haset 5-16 herë (Nation 1990:43-4). Nuk është e rastësishme se shumica e studimeve tregojnë përqindje të ulët të rezultateve të suksesshme dhe për rrjedhojë dhe të mësuarit të fjalëve.

Nga sa u tha më lart, lind pyetja: A është të mësuarit jo të drejtpërdrejtë, mënyrë produktive e të mësuarit të një gjuhe të huaj?

Të mësuarit jo të drejtpërdrejtë nuk duhet parë si një mënyrë e mëvetësuar e të mësuarit, por si një kombinim me të mësuarin e drejtpërdrejtë. Përfitimet që sjell të mësuarit jo të drejtpërdrejtë janë:

- Përfitimi i vogël mund të bëhet i madh, nëse tekstet që lexojnë nxënësit janë shumë. Është përllogaritur (Nagy 1997) se nëse do të lexonin një milion fjalë në tekst në vit dhe nëse 2% e tyre janë të panjohura, numri do të shkonte në 20.000 fjalë në vit. Dhe nëse do të mësonin 1 në 20, shumica vjetore do të ishte 1000 fjalë. Një milion fjalë janë afërsisht 10-12 romane.
- Me leximin e teksteve nuk mësojmë vetëm fjalë të reja, por edhe pasurojmë dijen leksikore të fjalëve tashmë të njohura. Për më tepër, përmirësojmë njohuritë gramatikore, familjarizohemi me strukturën e tekstit, përmirësojmë aftësinë në të lexuar, mësojmë informacione të reja.

Strategjitë e përvetësimit të fjalorit

Diçka shumë e rëndësishme që mund t'i ndihmojë nxënësit në përvetësimin e fjalorit të gjuhës së huaj është zhvillimi i strategjive. Studimi lidhur me strategjitë i ka fillesat në vitet '70 paralelisht me tendencën për kalim nga mësimdhënia me qendër mësuesin tek mësimdhënia me qendër nxënësin. Përfitimi më i madh i strategjive për nxënësit është se i ndihmojnë të bëhen të pavarur dhe të vazhdojnë të mësojnë dhe jashtë klasës përgjatë gjithë jetës.

Klasifikimi i strategjive për përvetësimin e fjalorit

Schmitt (1997) dallon dy kategori të mëdha:

- 1) Strategjitë për gjetjen e kuptimit të një fjale
- 2) Strategjitë e konsolidimit të kuptimit

1) Strategjitë e gjetjes së kuptimit të fjalës janë determinative kur i përdorim për të zbuluar kuptimin e një fjale të panjohur pa iu drejtuar dikujt tjetër. Mund të na ndihmojë për gjetjen e kuptimit njohja e kategorive gramatikore, analiza e pjesëve përbërëse të fjalës, vlerësimi i figurave në ligjëratën e shkruar dhe i gjesteve apo theksimit në ligjëratën e folur, vlerësimi i kontekstit, përdorimi i fjalorëve njëgjuhësh ose dygjuhësh, listat e fjalëve.

Strategjitë mund të jenë sociale kur i përdorim për të zbuluar kuptimin e një fjale duke iu drejtuar dikujt tjetër, mësuesit, një shoku klase apo një folësi natyral të gjuhës për të na dhënë përkthimin e fjalës, një sinonim, një përkufizim apo një fjali me këtë fjalë.

2) Strategjitë e konsolidimit i përdorim për të ruajtur në kujtesë kuptimin e një fjale. Këto dallohen në: sociale, të memories, kognitive dhe metakognitive.

Studime të mëpasshme (Fraser 1999, Huckin & Bloch 1993) kanë vënë në dyshim propozimin e Clarke & Nation (1980) për vonesë të strategjisë leksiko – qendrore që ka të bëjë me analizën e fjalës sipas përbërësve të saj, pasi analiza morfologjike e fjalës është një proces i drejtpërdrejtë dhe automatik që realizohet gjatë njohjes së fjalës. Për rrjedhojë, vonesa nuk është efikase, por ajo që mund të bëjmë është të fokusohemi në rrezikun që ekziston që nxënësit t'i drejtohen një përfundimi të gabuar, nëse bazohen vetëm në analizën e fjalës sipas përbërësve të saj dhe t'i ushtrojmë të kontrollojnë dhe të përpunojnë përfundimet e strategjisë në fjalë nëpërmjet vlerësimit të konsistencës së drejtpërdrejtë.

Në këtë eksperiment rezultatet treguan se pavarësisht se mësimdhënia e strategjive nuk ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në përmirësimin e njohurive leksikore, kishte ndikim jo të drejtpërdrejtë pasi nga njëra anë uli numrin e fjalëve që nxënësit shmangnin të kuptonin dhe nga ana tjetër përmirësoi cilësinë e përfundimeve.

BIBLIOGRAFÍA

- Bower, G. H & Clark, M. C. (1969), "Narrative stories as mediators for social learning. *Psychonomic Science*, 14(4), 181-2.
- Clarke, D. F. & Nation, I. S. P. (1980), "Guessing the meanings of words from context: strategy and techniques", *System* 8, 211-220.
- Haastrup, K. (1991), Lexical Inferencing Procedures or Talking about words.
- Nagy, W. (1997), *On the role of context in first and second language vocabulary learning* in Schmitt, N & McCarthy, M. *Vocabulary: Description, Acquisition and Pedagogy*, Cambridge: C.U.P.
- Nation, I.S.P. (1990), *Teaching and Learning Vocabulary*, Massachusetts: Newbury House.
- Nation, I.S.P. (2001), *Learning Vocabulary in Another Language*, Cambridge: C.U.P.
- Schmitt, N. (1997), *Vocabulary Learning Strategies* in Schmitt, N. & McCarthy, M. *Vocabulary: Description, Acquisition and Pedagogy*, Cambridge: C.U.P.
- Schmitt, N. (2000), *Vocabulary in Learning Teaching*, Cambridge: C.U.P.